

SHPALLJE VENDI I LIRË PUNE

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Shef finance	Rep.1030	Berat	3-muaj	po	po	30.07.2018	13.08.2018
2								

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës:	Shef Finance
2. Kodi i pozicionit:	FT1030A08001
3. Reparti/Institucioni:	Reparti Ushtarak nr.1030, Forca Tokesore.
4. Vendi:	Poshnje, Berat
5. Paga:	VKM nr.187, datë 08.03.2017
6. Lloji i kontratës së punës:	3 - muaj
7. Data e fillimit të aplikimit:	30 Korrik 2018
8. Data e mbylljes së aplikimit:	13 Gusht 2018
9. Mënyra e aplikimit:	<p>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Mbrojtjes, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën:</p> <p><i>Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i></p> <p><i>Ministria e Mbrojtjes</i></p> <p><i>Rruga e Dibrës</i></p> <p><i>Tiranë</i></p>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e arsimit të lartë të noterizuar ose në origjinal sëbashku me listën e notave.
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjeko-ligjor;
- fotografi me përmasa 4x6, dhe 9x12, nga 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [ëëë. mod.gov.al](http://mod.gov.al). (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: **Shëf Finance**
- b. Arsimi : Arsim i lartë (civil)
- c. Kualifikimi: I lartë, Ekonomik
- d. Trajnimi: Trajnim në fushën e kërkuar
- e. Eksperienca në Punë: Të ketë eksperienca të mëparshme në fushën financiare.
- f. Gjuha e huaj: Anglisht.
- g. Kërkesa të tjera specifike:
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Konfidencial

13. Përshkrimi i punës:

a. Detyrat kryesore:

- Organizon dhe drejton gjithë aktivitetin financiar të batalionit dhe mban përgjegjësi të plotë për ecurinë e tij.
- Këshillon komandantin për problemet e buxhetit, çështjet ekonomiko-financiar, ato në fushën e administrimit si dhe për zbatimin e akteve ligjore dhe nën/ligjore për trajtimin financiar të personelit.
- Përpilon dhe përgatit për miratim dokumentacionin e pagesës së pagave të personelit të (reparti ushtarak nr 1030).
- Përgatit dokumentacionin për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore. (deklarimi online).
- Ndjek dhe kontrollon inventarizimin e vlerave materiale.
- Merr dhe raporton në kohë evidencat operative dhe periodike, situacionet e bilancet sipas afateve të caktuara ligjore.
- Hedhja e të gjitha pagesave në programin Alfa WEB.
- Mbikëqyr harxhimin e fondeve dhe organizon qarkullimin e dokumentacionit financiar.

b. Përgjegjësitë:

- Programon dhe realizon auditimin e brëndshëm ekonomiko – financiar.
- Mbikëqyr llogarin monetare që përfshin pagesat, shpeblimet, likuidimet për furnizimet, investimet, pajisjet dhe shërbime të siguruar e për të mbështetur shërbimin logjistik.

14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerezore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me gojë me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerëson në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.